VENDIM
Nr.19, datë 8.3.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË "ALBANIAN GREEN ENERGY" SHPK

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1 germa "a", dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.3.2010, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k.,

dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për fillimin e punimeve për ndërtimin e centraleve, TEC me biomasë të lëngshme, për shkak se ende nuk ka marrë autorizimin e linjës tregtare nga pala italiane, duke qenë se ndërtimi i linjave të interkonjeksionit, përveç etapave administrative në të cilat kalon çdo projekt, përbën akoma një teknologji jo shumë të njohur në vend dhe që kërkon asistencën teknike të huaj.

Për gjithë sa më sipër,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.89, datë 6.8.2008 për dhënien e licencës shoqërisë "Albanian Green Energy" sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, bllok motorë, gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, të bëhen këto ndryshime:

Pika 1, gErma "d" të ndryshohet si më poshtë:

"d.1 Afati i fillimit të punimeve për realizimin e projektit do të jetë deri në 18 muaj, në përputhje të afatit të përcaktuar në lejen e METE-s nr.4/1, datë 7.12.2009, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.31, datë 20.1.2010 për ndërtimin e linjës tregtare të interkonjeksionit.

d.2. Koha e zbatimit të të gjithë projektit, përfshirë dhe kolaudimin e veprës do të jetë 36 muaj nga realizimi i afatit të përcaktuar në pikën d.1".

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë "Albanian Green Energy" për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta